



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 qershor 2020
Nr. ref.:RK 1577/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI04/20

Parashtrues

Lulzim Sadiku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së “aktgjykimit të pretenduar të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 494/16, të 11 nëntorit 2016”

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lulzim Sadiku, i cili aktualisht është duke vuajtur dënimin me burg në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e *“aktgjykimit të pretenduar të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 494/16, të 11 nëntorit 2016”*.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së *“aktgjykimit të pretenduar”*, me të cilin, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur, por nga Gjykata kërkon që *“... të shpallet pafajësia ime, dhe të vihen para ligjit ata që e përkrahin edhe në këtë kohë krimin dhe të më lironi nga aktakuzat e montuara...”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) me një letër të palexueshme që nuk plotësonte kërkesat themelore për t'u regjistruar si një rast i ri në Gjykatë.
6. Më 26 dhjetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës se kishte pranuar letrën e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës dhe i sqaroi parashtruesit se nëse dëshiron që Gjykata ta regjistrojë rastin e tij në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet ta plotësojë formularin e kërkesës, të theksojë se cili akt i autoritetit publik kontestohet dhe të dorëzojë kopjen e aktit të kontestuar, si dhe se ai është i obliguar të deklarojë se cilat të drejta i janë shkelur.
7. Më 14 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e kërkesës me postë në Gjykatë.
8. Më 15 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 28 shkurt 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës se ajo e kishte pranuar formularin e kërkesës dhe se e kishte regjistruar atë në regjistrin përkatës me numër KIo4-20. Me të njëjtën shkresë, Gjykata kërkoi nga

parashtruesi i kërkesës ta specifikojë kërkesën brenda 15 ditëve dhe të theksojë se cilat të drejta i janë shkelur, cili është akti i autoritetit publik që ai e konteston dhe ta dorëzojë një kopje të të njëjtit.

10. Më 20 mars 2020, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës me një shkresë, në të cilën theksoi:

“...Si person fizik, më 26 dhjetor 2019, i kam shkruar të gjitha faktet sipas datave dhe me vendimet e gjykatave konkrete, ju kam njoftuar në detaje për të gjitha, duke llogaritur se kjo kërkesë e imja do të merret në shqyrtim nga ana e juaj, ka mjaft fakte që të fillohet procedura e shqyrtimit të kësaj kërkesë, në të cilën gjithçka është shkruar në detaje pa ndonjë tendencë dhe pa ndonjë qëllim tjetër, përveç se të dëshmohet zyrtarisht pafajësia ime, ku unë jam në gjendje të përballem me cilindo institucion dhe individ, para drejtësisë suaj...”

11. Më 27 maj 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Gjykata nuk i referohet fakteve të këtij rasti, pasi që parashtruesi i kërkesës paraqiti gjendjen faktike në mënyrë të paqartë dhe nuk dorëzoi në Gjykatë *“aktgjykimin e pretenduar të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 494/16”* të cilin parashtruesi i kërkesës po përpiqet ta kontestojë, ose ndonjë dokument tjetër të një autoriteti publik, nga i cili Gjykata do të mund të njoftohej me gjendjen faktike.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi nuk thekson se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me *“aktgjykimin e pretenduar të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 494/16”*.
14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“...të shpallet pafajësia ime, dhe të vihen para ligjit ata që e përkrahin edhe në këtë kohë krimin dhe të më lironi nga aktakuzat e montuara...”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

17. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

„1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

18. Në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kërkesat kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së tij, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore nga një “autoritet publik”, pasi i kanë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kusht përcaktohet edhe në nenin 47 të Ligjit.
19. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit posaçërisht i obligon parashtruesit e kërkesës të theksojnë qartë aktin konkret të autoritetit publik të cilin ata e kontestojnë. I njëjti nen gjithashtu i obligon parashtruesit e kërkesës të tregojnë qartë se cilat të drejta dhe liri ata pretendojnë se u janë shkelur.
20. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Nëse kërkesa [...] nuk është [...] e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...].”

21. Gjykata më tej i referohet rregullit 32 (2) (h) [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

22. Gjithashtu në lidhje me këtë, Gjykata më tej i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

[...]

(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze.”

23. Para së gjithash, Gjykata gjithashtu rikujton se ajo dy herë i është drejtuar me letër parashtruesit të kërkesës duke kërkuar që ai t'i dorëzojë në Gjykatë aktet e autoriteteve publike të cilat ai i konteston dhe ta sqarojë kërkesën, si dhe të tregojë saktësisht se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur. Konkretisht, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës letër më 26 dhjetor 2019 dhe 28 shkurt 2020, megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk i dorëzoi dokumentet e kërkuara dhe nuk sqaroi kërkesën, dhe as nuk deklaroi se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur.
24. Gjykata konstaton se parashtruesi nuk e ka dorëzuar në Gjykatë “*aktgjykimin e pretenduar të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 494/16*” të cilit parashtruesi i kërkesës po përpiqet ta kontestojë, dhe vërtetësinë e të cilit Gjykata nuk mund ta përcaktojë për shkak të dështimit të parashtruesit për ta dorëzuar të njëjtin. Gjithashtu, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk deklaroi se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur dhe nuk e sqaroi kërkesën.
25. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar informata, të cilat Gjykata u përpoq t'i merrte dy herë nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa është e paplotë dhe se kërkesa nuk është e qartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës për ta plotësuar ose sqaruar kërkesën (shih Vendimin për refuzimin e kërkesës të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI121/18 *Gëzim Murati* i 14 dhjetorit 2018, paragrafi 31; si dhe Vendim për refuzimin e kërkesës të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI03/15, parashtrues: *Hasan Beqiri*, i 13 majit 2015, paragrafët 17- 19).
26. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet procedurale për shqyrtim të mëtutjeshëm, për shkak se kërkesa nuk është e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, siç parashihet me nenin 22

paragrafi 4 dhe nenin 48 të Ligjit, si dhe rregullat 32 (2) (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (2) (h) dhe 35 (5) të Rregullores së Punës, me 26 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJE kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJE këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi